

# „THE LEGEND OF ROZAFÄ“, THE VOICE OF THE NOVEL „BRIDGE WITH THREE ARCHES“ BY ISMAIL KADARE

## „LEGJENDA E ROZAFËS“, ZËRI I ROMANIT „URA ME TRI HARQE“ TË ISMAIL KADARESE

Adelina XHAFFERI<sup>1</sup>

<sup>1\*</sup> Department of Albanian Language and Literature, Faculty of Philology, University of Tetova

\*Corresponding author e-mail: adelina.xhaferi@unite.edu.mk

---

### Abstract

The relationship that an old text has with a new one, is one of the most beautiful features in the field of literature. The transfer of different literary elements from old times to present and from popular creators to artistic creators is one of the most special transfers in the world of beautiful words, otherwise known as intertextuality. The last one, emerging from time to time and from one author to another author, could not be far from Ismail Kadare's artistic creations as a creator and representative of the Albanian literature in all the literary spaces of the world. Therefore, it turns out that the first purpose of the paper is to show how the popular legend of Rozafa of Shkodra as an old text is the text on which the new text is built. That is, Kadare's artistic prose selected to be studied in this paper, as literary elements emerge with a second artistic nature. Whereas, as a second goal, the presentation of elements carried over at different times from each other, emerges. In order, to present these two goals within this paper on two selected texts, as well as to present intertextuality as a feature of literature, the method of deduction and the method of analysis will be used.

**Key words:** sacrifice, folk legend, woman, Albanian prose, society.

### Përmbledhje

Raporti që një tekst i vjetër ka me një tekst të ri është njëri ndër tiparet më të bukura në fushën e letërsisë. Bartja e elementeve të ndryshme letrare nga koha e vjetër në kohën e re dhe nga krijuesit popullorë te krijuesit artistikë është njëra ndër bartjet më të veçanta në botën e fjalëve të bukura, e njohur ndryshe si intertekstualitet. Ky i fundit duke dalë nga koha në kohë dhe nga autori në autor, nuk mund të ishte as larg krijimeve artistike të Ismail Kadaresë si krijues dhe përfaqësues i letërsisë shqipe në mbarë hapësirat letrare të botës. Andaj, duke u ditur kjo gjë del se qëllimi i parë i punimit është të tregohet se si legjenda popullore e Rozafës së Shkodrës si tekst i vjetër është teksti mbi të cilin ndërtohet teksti i ri, pra proza artistike e Kadaresë e përzgjedhur për t'u studiuar në këtë punim, si dhe cilat elemente letrare dalin me natyrë artistike te e dyta. Ndërsa, si qëllim i dytë del paraqitja e elementeve të bartura në kohë të ndryshme nga njëra-tjetra. Për t'u paraqitur këto dy qëllime brenda këtij punimi mbi dy tekste të përzgjedhura, si dhe për ta paraqitur intertekstualitetin si tipar letërsie do të përdoret metoda e deduksionit dhe metoda e analizës.

**Fjalët çelës:** flijimi, legjenda popullore, gruaja, proza shqipe, shoqëria.

## Hyrja

Krijimtaria popullore gjithnjë e më shumë është treguar një burim i pashterur i krijuesve shqiptarë gjatë gjithë periudhave të njëpasnjëshme të letërsisë shqipe. Duke qenë e plotë në vetvete dhe e bollshme për nga tematikat, motivet letrare, natyrat dhe karakterizimet a tipizimet e personazheve, shpërthimet e ndryshme lirike, hapësirat e ndërveprimit të po atyre personazheve, kapërcimit të kohës si faktor ndërtues dhe themelor për një rrëfim të ri, apo e bollshme edhe për bartjen e elementeve të bukura nga njëra kohë në tjetrën, kjo krijimtari me natyrë popullore arriti që ta ruajë natyrën e saj dhe ta gjejë vetveten edhe në kohët e mëvonshme.

Andaj, duke u njohur kjo gjë, duke u ditur ndërtimi i gjithçkaje me natyrë të thjeshtë dhe duke u parë nga një autor tek një autor tjetër ndikimi i krijimtarisë (letërsisë) popullore, bartja e këtyllë letrare është njëra ndër më të bukurat në faqet e letrave shqipe, sidomos në krijimet letrare të periudhës bashkëkohore. Në mesin e shkrimtarëve që zënë vend në këtë të fundit, tashmë dihet se një vend të veçantë zë edhe krijimi i Ismail Kadaresë. Larmia e madhe që krijimtaria popullore ka në vetvete, bëri që edhe në kohët e mëvonshme të letërsisë shqipe, një letërsi që tashmë e kishte krijuar dhe ndërtuar vetveten mbi një bazë të fortë dhe të nevojshme për të qëndruar në këmbë edhe në kohët e mëvonshme, të ndërtoheshin krijime të bukura letrare, të cilat në një mënyrë a në një tjetër do ta kishin në vetvete një element të moçëm popullor.

Larmia e tillë në veprat e mëvonshme letrare nuk u pa vetëm në përzgjedhjen e një tematike të caktuar për t'u trajtuar sipas kohës në të cilën vihej nga autori, e ndërlidhur me nevojat e saj, por edhe në veprimet, realizimet, paraqitjet e jashtme, apo rritjet e brendshme të plota të personazheve të caktuar apo të subjekteve lirike. Duke e njohur këtë gjë dhe duke e parë rrjedhën e letërsisë, nuk është aspak e rastësishme se përse në morinë e madhe të veprave letrare të letërsisë shqipe në kohët e mëvonshme (përfshirë edhe krijimet e kohës së sotme) shihen shumë personazhe dhe subjekte lirike që për veprime dhe qëllime të caktuara ngajnë të njohur, janë zëra që kanë folur dhe janë ngritur në një kohë tjetër, apo që shumë lehtë, me elemente të thjeshta dhe rrjedhë të natyrshme bëhen pjesë e përditshmërive të kohëve të tjera.

E tillë është edhe fryma e Rozafës, gruas që doli një mëngjes të hershëm nga toka arbërore dhe bëri që të tjerët ta njihnin jo vetëm për flijimin e saj njerëzor përballë një djali të vogël që priste të përkundej e të rritej, por edhe për përshkrimin e një nëne të fuqishme shpirtërisht, të një gruaje shqiptare me një sy, një gj, një dorë dhe një këmbë të lënë jashtë murit në të cilin i ishte (para)caktuar që t'i sosej jeta. Shoqëria njerëzore është mësuar që ta zhvillojë, ta rrisë dhe ta realizojë vetveten e saj duke lënë gjurmë të njëpasnjëshme në hapësirat e tokës, të cilat si të tilla do të flisnin për mënyrën e zhvillimit të saj dhe për të gjitha nevojat me të cilat vishej nga koha në kohë.

Si e tillë, duke e rritur vetveten me të gjitha elementet që i ishin (para)caktuar brenda kornizave të dhëna dhe duke kaluar nga njëra shkallë në shkallën tjetër, ajo arriti që, për dallim nga çdo gjë tjetër, ta ngërthente në vetvete edhe një frymë personazhi që në thelb e paraqiste shenjën themelore me të cilën në të djeshmen, ishte identifikuar shoqëria në të cilën bënte pjesë ai si personazh. Në këtë mënyrë, të gjithë autorët që bënin pjesë në këtë shoqëri duke e kapërcyer njëkohë drejt tjetrës e panë të nevojshme që të krijonin diçka të re, me natyrë dhe kohë të veçantë, apo herë të tjera ta bartnin natyrshëm një element të djeshëm, pra një element të vjetër në natyrën e shoqërisë së sotme.

Të gjitha këto do të ndihmonin që letërsia si art i kultivuar që në lashtësi, apo si një shpërthim i brendshëm i qenies njerëzore si bartëse e saj nga koha në kohë të bëhej e plotë, të ishte e larmishme, si dhe ta jepte te shoqëria në mënyrë të dukshme atë gjë të cilën kohët në rrjedhë të tyre nuk do të arrinin ta ndryshonin.

## Krijimi i gurtë letrar i Kadaresë

Nisur nga një përvojë e bollshme dhe e pasur popullore Ismail Kadare arriti që ta ndërtojë njërën ndër prozat më të veçanta të krijimtarisë së tij letrare, të dukshme në mesin e prozave të tjera jo vetëm për tematikën e moçme të flijimit njerëzor, por edhe për rrjedhën e lehtë të rrëfimit për një ndërtim të gurtë në një kohë të ftohtë e të egër shqiptare. I nxitur për ta bërë pjesë të letërsisë artistike dhe të letrave shqipe këtë bartje interesante që vjen jo më larg se nga koha e djeshme e funksionimit të arbërve, e sotmja e tij (pra e sotmja e Kadaresë) kërkonte që sërish në vetvete ta kishte një flijim të ri njerëzor dhe një jetëgjatësi të një ndërtimi prej guri.

Andaj, duke e ditur faktin se ky shkrimtar është njëri ndër më të zëshmit për risjelljen në kohën bashkëkohore të tematikave, motiveve të moçme popullore dhe personazheve me fat të (para)caktuar, të cilët në mënyra të ndryshme arrijnë të bëjnë zë, duhet thënë se një punë me vlerë, një rrjedhë të lehtë dhe një rrëfim të veçantë Kadare solli edhe në prozën e përzgjedhur për këtë studim/vështrim të shkurtër letrar. Vetëm në këtë mënyrë duke kaluar kohët dhe duke u parë dukshëm kapërcimi i një personazhi të moçëm nga një tematikë drejt një tematike tjetër, duhet thënë se letërsia shqipe është e veçantë dhe e plotë në vetvete për mënyrën e rrjedhës së rrëfimit, për mënyrën e zërit të personazheve, si dhe njëkohësisht e plotë edhe për paraqitjen e asaj që vjen nga e djeshmja popullore.

Sa herë që flitet për krijimet letrare të Kadaresë, si përfaqësues i periudhës bashkëkohore shqipe në të gjitha hapësirat që bëhen me frymë të veçantë falë fjalëve të bukura e të përzgjedhura shqipe, proza e tij *“Ura me tri harqe”* shihet se guxon ta vë në pah një rrëfim të thjeshtë dhe të lehtë mbi një fat të vjetër të personazheve të tokave të Arbërit. Personazhet e kësaj proze në shumicën e kohës shihet se vrapojnë dhe sillen rreth rrëfyesit të ngjarjes, por nuk mungojnë as rastet kur ky i fundit vihet vetë në komunikim të menjëhershëm me ta, falë një guri të vënë në urë, një këmbë të urës të ngritur gjatë natës, apo falë një force të brendshme për ta parë përditë trupin e flijuar të një burri (personazhi) të zakonshëm, më të zakonshëm se të zakonshmit tjerë siç thekson vetë rrëfyesi i ngjarjes së moçme.

Me një simbolikë të veçantë dhe me një të kaluar të fuqishme për shpërthimin njerëzor kjo vepër letrare, duke qenë zë rrëfyes, pjesë përfaqësuese e letërsisë bashkëkohore shqipe nuk e ngërthen në vetvete vetëm ndërtimin e urës mbi të cilën duhej të kalonin qeniet njerëzore të kohës në fjalë, me të gjitha brengat të cilat i kishin në vetvete, nuk e ngërthen as vetëm ecjen e një njeriu të pafajshëm dhe më të rëndomtë se të gjithë të tjerët drejt një fundi pa bërë zë dhe pa e thyer heshtjen e natës, por edhe raportin e vazhdueshëm që njeriu ka me vdekjen. Andaj, jo më kot, duke u mbështetur në këtë kundërshti të vendosur në vijë paralele dhe të moçme sa vetë jeta e shoqërisë njerëzore, në një vepër studimore mbi prozën e Kadaresë thuhet se: *“Raporti ndërmjet jetës dhe vdekjes, ndërmjet të gjallëve dhe varreve, ndërmjet brezit që shkoi dhe atij që vjen, një nga raportet më thelbësore të qenies njerëzore, përbën një rregullator të mbifujshëm të gjithë yllësisë së veprave të Kadaresë”*.<sup>118</sup>

Për dallim nga çdo rrëfim tjetër i tij që nisat për ta bërë të zëshëm një personazh që frymon lirë dhe që i pritet e nesërmja jashtë mureve dhe urave të gurta në tokë, në truall të synuar nga të huajt, në këtë prozë bashkëkohore e nesërmja e personazhit të murosur në urë, që zgjedh të mos bëjë zë dhe të futet në faqet e romanit pa u dukur aspak përpara murosjes së tij, është një e nesërme e ftohtë dhe e largët për kohën në të cilën vendoset për veprim.

Sepse, nëse bota e lexuesve është mësuar që në periudhën bashkëkohore të letërsisë shqipe nga autorë të ndryshëm të njihet dhe të mishërohet me personazhe që janë reflektim apo pasqyrim i një nevojë të përbashkët shoqërore përballë një të keqeje të jashtme, në këtë prozë bashkëkohore lexuesit shohin një murosje të befasishme, një habi të një murgu kundrejt veprimeve të një burri që e flijon jetën dhe që bëhet njësh me këmbët e urës, apo edhe një ndërtim dyvjeçar të një ure mbi të cilën nuk mund të kalohej lirshëm dhe pa frikë.

<sup>118</sup> Shaban Sinani, (2009), Për prozën e Kadaresë, Naimi, Tiranë, f. 53.

## Bartja e motivit të flijimit nga legjenda në roman

Që në kohët e hershme njerëzit dhe shoqëria njerëzore janë ndjekur nga një fat i bartur nga njëra kohë në tjetrën, për ta dhënë në vetvete nevojën e vazhdueshme që një element i bukur nga e kaluara, me të gjitha karakteristikat e tij të bëhet pjesë e asaj që frymon në të sotmen (do të thotë në kohën kur ai element vihet në dukje). Një rast i tillë në shoqërinë njerëzore, pas një vetëdijesimi të dukshëm, shihet edhe në bartjen e elementeve letrare, të cilat duke qenë të veçanta dhe të bollshme për nga paraqitja e vetvetes mund të barten nga një krijim letrar te një krijim tjetër, ndonëse njëri mund të mos jetë me paraqitje, natyrë të theksuar artistike të kohës së re.

Rast i tillë në krijimtarinë letrare të popullit shqiptar me një natyrë të veçantë dhe me një bartje të lehtë për kah koha e autorit është ai i zërit të legjendës së flijimit të gruas shqiptare, të një nëne të re me një foshnjë që duhej të pinte gjë në brendinë dhe rrjedhën e ngjarjeve të një romani bashkëkohor, duke e pasur në vetvete si shumë krijime të tjera dilemën e trashëguar mbi të cilën ndonëse ka rënë e nesërmja, nuk është zgjidhur ende. Ashtu siç kjo dilemë e moçme e ndërtimit të një ure a të një kështjelle në truallin e Shqipërisë së romanit zë vend të veçantë dhe të bollshëm në këtë prozë bashkëkohore, studiuesit thonë se e tilla e ka ndjekur fatin e çdo populli, sidomos atë të Ballkanit gjatë gjithë kohës, andaj është në interes të punimit të theksohet ajo që është thënë me kohë, se: *“Të gjithë popujt e Ballkanit, të vjetër e të rinj, ndër ta edhe shqiptarët, nga njëri shekull në tjetrin i kanë përcjellë epokat me dilemën tronditëse “një urë apo një kështjellë”? Përpara kësaj dileme, me karakter thelbësisht qenësor, popujt janë ndalur për të menduar gjatë, kanë marrë vendimin dhe pastaj kanë ndërruar mendje, kanë vendosur ndryshe dhe prapë janë kthyer te vendimi i parë, duke ardhur deri në ditët tona me përfundimin historik se ura dhe kështjella, në mos qofshin njësoj të domosdoshme për mbijetesën e brezave, të paktën janë simbole jetike e letrare që rregullisht alternojnë njëri-tjetrin, duke mos i krijuar asnjë vështirësi artistike krijuesit, me emër ose anonim qoftë”*.<sup>119</sup>

Në këtë mënyrë, siç shihet në vetë rreshtat e paraqitur më lart, del se ndërtimi i gjërave të gurta mbi të cilat ngrihen fate dhe ngjarje të personazheve të kohëve të ndryshme, nuk janë ndërtuar vetëm për ta mbrojtur një vend të caktuar brenda tokës shqiptare (dhe jo vetëm), por për ta ngritur një urë, një kala a një kështjellë te e cila do të shihej lidhja që një popull i caktuar (siç është rasti i popullit shqiptar) do ta kishte me një popull tjetër të largët nga vetvetja në kohë e hapësirë gjeografike (apo edhe në mendime). Bartjen e motivit të flijimit (qoftë i flijuari njeri, apo perëndi), motiv ky të cilin edhe populli shqiptar e ka trashëguar në krijimet e tij që nga koha e lashtë, në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe me elemente të bartura në mënyrë të hapur lexuesit dhe studiuesit e shohin edhe në romanin bashkëkohor *“Ura me tri harqe”* të Ismail Kadaresë.

Në këtë roman gjithë rrjedha e rrëfimit sillet rreth nevojës së ndërtimit të një ure, te e cila do të kalonin njerëzit e ditëve të ardhme dhe njëkohësisht do të ndërpritej kapërcimi i ujit për nevoja të caktuara nëpërmjet njerëzve me synime të fshehta përfitimi. Andaj, nuk është e rastësishme se përse në brendi të romanit shumë shpesh hasen edhe kundërshtimet e vazhdueshme rreth ndërtimit të kësaj ure, që çon në flijimin e papritur njerëzor dhe ngurtësimin e çdo personazhi që ishte pjesë e familjes (dhe jo vetëm) së personazhit që u flijua në mënyrë të rëndomtë.

Flijimi i tij, përveç tronditjes së madhe të nënës së të flijuarit me dhimbje të mëdha, a pikëpyetjeve të shumta se përse ata që nuk bënin zë duhet të ishin gjithmonë ata që e jepnin veten dhe *“u hahej koka”*, në raste të tjera gjatë dialogëve të personazheve thuhet se është një rast i mirë dhe i nevojshëm për krijimin e një të ardhmeje më të mirë dhe vazhdimësi e asaj që popujt duhej ta ruanin në vetvete. Për këtë arsye, duke u mbështetur në veprimet e personazheve dhe në funksionimin e tyre të bartur nga koha e fljimeve të dukshme vetëm nëpër legjenda popullore, është thënë se: *“Zgjedhja midis urës dhe kështjellës, ose e të dyjave bashkë, si dy*

<sup>119</sup> Shaban Sinani, (2009), Për prozën e Kadaresë, Naimi, Tiranë, f. 32.

vepra që e meritojnë fljimin njerëzor, është përcaktuar jo vetëm nga rrethanat e ndërlikuara historike që kanë përcjellë fatin e popullit shqiptar, por edhe nga vetëdija e tij krijuese. Përpara pyetjes tronditëse “një urë apo një kështjellë”, që mund të thuhet se është një prej trazimeve më të mëdha të një bashkësie, një prej vendimeve më të vështira të një populli, kënga është ndalur. Deri në ditët tona ka ardhur si një përfundim historik se ura dhe kështjella u janë dashur brezave si kushte themelore të vazhdimësisë”.<sup>120</sup>

Në këtë mënyrë, duke u mbështetur te të dy tekstet të cilët janë përzgjedhur për këtë punim, shihet se në pah del dukuria letrare e quajtur intertekstualitet, e cila e thekson dhe e bën të dukshëm faktin që në punim teksti i parë, pra “*Legjenda e Rozafës*” është teksti bazë mbi të cilin është ndërtuar teksti i dytë, pra romani bashkëkohor “*Ura me tri harqe*” i Kadaresë. Të dy tekstet në fjalë, ndonëse njëri është tekst popullor dhe tjetri tekst me elemente artistike, nuk e kanë në vetvete vetëm motivin e fljimit (të një gruaje/nëne a të një burri/babai), por edhe elementin e gurit, i cili do ta ndihmonte ndërtimin e një të ardhmeje më të mirë, duke u mbështetur në një “trup të lënë në mur” dhe në një jetë të re të lënë pa rritje të vërtetë.

Në mesin e rreshtave të legjendës së Rozafës me të cilën në të gjitha kohët identifikohet e kaluara e popullit shqiptar, një legjendë kjo e ndërtuar mbi truallin e moçëm të Shkodrës, truall i moçëm dhe i ruajtur po aq sa dhe vetë kështjella, është theksuar se qëndron në vetvete historia e plotë e funksionimit shoqëror të kohës dhe të gjitha mënyrat me të cilat kjo shoqëri e rriste apo e tjetërsonte vetveten përballë ndryshimeve të cilat i vinin si pasojë e një (pa)fati.

Andaj, duke u ditur kjo gjë dhe duke u parë prania e kësaj legjende popullore në të gjitha kapërcimet e kohës, kohë më parë autori ka theksuar se në këtë legjendë dhe pasuri popullore “*njeriu mund të gjejë edhe dorëzimin në dorë të shortit, edhe sakrifikimin e vetëpranuar; edhe besën, mbajtjen e fjalës së dhënë, edhe shkeljen e paktit dhe prishjen e marrëveshjes (dy nga vëllezërit dalin fjala për të mos u treguar grave se ajo që do të sjellë bukën, do të nguroset, vetëm i vogli e mban premtimin); edhe heroizmin epik, edhe krimin (a mund të mendohet një vepër më kriminale se varrimi për së gjalli i një nëne të re?); edhe vdekjen, edhe mbijetesën; edhe vendosmërinë njerëzore, edhe fuqinë hyjnore (çfarë mund të quhet patriarku këshilltar, që u shtie në mendje murimin tre vëllezërve?)*”.<sup>121</sup>

“*Unë, murgu Gjon, i biri i Gjorg Ukcames, tue u kujtuom se në gluhën tonë ende s’ka gja të shkruom për urën mbi Ujanën e Keqe, aq më keq, kur për të vazhdojnë të thuren gojëdhëna e histori të paqëna e gjithfarë dokrrash, tani që ajo mbaroi së ndërtuari, madje që u spërkat edhe dy herë me gjak, në themel e në kulm, vendosa të shkruaj kronikën e saj.*”<sup>122</sup>

Në këtë mënyrë dhe me këtë identifikim personazhi e fillon prozën e tij rrëfimore Ismail Kadare, shkrimtari përfaqësues i letërsisë shqipe nëpër cepa të ndryshëm të botës. Duke e sjellë në kohën e rrëfimit të tij dhe në urën mbi Ujanën e Keqe fatin e një personazhi të lashtë dhe të nevojshëm për ta njohur nga koha në kohë, vetë Gjonin, të birin e Bdek Buzukut, autori dëshmon se mbi shpatullat e tij nuk kishin mbetur vetëm fjalët të cilat e tregonin fatin e atij që netëve të vona fljiohej për të mirën njerëzore, por edhe meshat e ndryshme të shoqërisë shqiptare të cilat duhej t’i bartte për ruajtjen e gjuhës dhe historisë: “*U Don Gjoni, biri i Bdek Buzukut, tue u kujtuom shumë herë se gluha jonë nukë kish gja të ndigluom n së Shkruomit shenjtë, n së dashunit së botës së sanë desha me u fëdigunë, për sa mujta me ditunë, me zditunë pak mendetë e atyre qi të ndigloninjë, përse ata të mundë mernë sa i naltë e i mujtunë e i përmishëriershim anshtë Zotynë atyne qi ta duonë m gjithë zemërë.*”<sup>123</sup>

Duke qenë se në këtë roman fljimi i personazhit të Kadaresë për të qëndruar ura mbi Ujanën e Keqe ndodh gjatë kohës së natës, për dallim nga legjenda që zhvillimin e ngjarjeve të personazheve legjendarë e vendos gjatë kohës së ditës, murgu Gjon, rrëfyeti i ngjarjes e ka të

<sup>120</sup> Shaban Sinani, (2009), Për prozën e Kadaresë, Naimi, Tiranë, f. 33.

<sup>121</sup> Po aty, f. 36.

<sup>122</sup> Ismail Kadare, (2004), Ura me tri harqe, Onufri, Tiranë, f. 11.

<sup>123</sup> Eqrem Çabej, (2013), Meshari i Gjon Buzukut 1555, Çabej, Tiranë, f. 387.

nevojshme dhe të detyrueshme që të bëhet dëshmitar i ndodhisë së pazakontë dhe ta vazhdojë natyrshëm historinë mbi të cilën ishte ngritur dikur vetë historia e popullit të tij shqiptar.

Andaj, në mënyrë të vetëdijshme, duke i parë të gjitha të vërtetat dhe të pavërtetat të cilat sillëshin në kokat e personazheve (njerëzve) të kohës duke u mbështetur në përditshmërinë e tyre, po aq sa koha në të cilën ishte lënë fati i Murrash Zenebishës si personazh, ai i thotë fjalët e mëposhtme, të cila janë zëri i bartur nga koha në kohë drejt romanit në fjalë: *“Që të mos thonë të qena dhe të paqena për këtë urë në të njëmbëdhjetë gjuhët e gadishullit, unë do të përpiqem të shkruaj gjithë të vërtetën për të, domethënë të shkruaj gënjeshtërën, ashtu siç dukej, dhe të vërtetën, ashtu siç nuk dukej, të shënoj ngjarjet e përditshme, që janë të rëndomta si gurët, dhe tmerret e mëdha, që janë afërsisht aq sa ç’është numri i harqeve të saj. Tani karvanet dhe karvanarët po e përhapin anembanë tokës së madhe ballkanike gojëdhënë e theorisë, që kinse u bë në këmbët e urës. Të paktë janë ata që e dinë se kjo nuk ishte fli kushtuar orëve të ujit, por thjesht një krim i zakonshëm, dëshmitar i të cilit dhe i gjërave të tjera unë do të bëhem përpara mijëvjeçarit tonë.”*<sup>124</sup>

Më pas në brendi të romanit në fjalë, i cili tashmë siç u theksua disa herë në punim është zëri i legjendës së moçme shqiptare, te e cila ngërthehen dy fate të çuditshme dhe jo të natyrshme personazhesh (Rozafës dhe Murrashit, ndonëse njëra e dalë nga legjenda dhe tjetri nga romani) flitet se shenjat me të cilat njerëzit e kohës e kuptonin natyrën dhe gjërat që duhej të ndodhnin ishin të natyrave të ndryshme e të shumta dhe se të gjitha duhej të kishin një arsye për të ndodhur. Në këtë mënyrë ata e shpjegojnë edhe ndërtimin e urës mbi Ujanën e Keqe dhe të njeriut që bëhet pjesë e tokës, duart dhe trupi i të cilit sipas tyre duke qenë se flisin/ndeheshin vetëm në drejtim të lumit dhe ndërtimit të një ure, duke u dridhur për ta përshkruar dridhjen e paraqitur në legjendë, të cilën e uron Rozafa, kjo nënë e re shqiptare në variante të ndryshme të këtij krijimi, është e nevojshme të përmendet se ndërtimi i urës me tri harqet e saj në kohën e romanit i zë dy vite.

Këtë ndërtim autori në roman e jep që nga ardhja e njerëzve të parë, të cilët do të ndihmoheshin edhe nga të tjerë, deri në përfundimin e tij me përshkrime të njëpasnjëshme të gjurmëve, planifikimeve dhe shpesh edhe të gropave të ndryshme, të cilat sipas njerëzve të vendit nuk çonin askund. Duke e ndjekur këtë rrjedhë kohe dhe duke qenë pjesë e ndodhive të njëpasnjëshme të kohës së romanit, si tekst i ngritur mbi një motiv mjaft të moçëm të shoqërisë shqiptare, murgu Gjon me anë të fjalëve të përzgjedhura dhe me nevojën e vazhdueshme të vetvetes që të mbetet dëshmitar kohe, për urën e gurtë mbi Ujanën e Keqe bën të ditur se *“gjer në fund të prillit mbërritën edhe dy karvanë të tjerë, por puna për ndërtimin e urës nuk filloi veçse me ardhjen e shestuesit. Tani e thërrisnin kryemjeshtër, ngaqë, me sa dukej, ishte po ai që do të udhëhiqte ndërtimin e urës. Gjermimi filloi larg, anash, te shkurnajat, thua se ura do të ishte andej tutje, sa më larg ujërave. Hapeshin gjithfarë gropash e hullish, që nuk çonin asgjekund.”*<sup>125</sup>

Për të vazhduar më pas me po atë rrjedhë të lehtë e të thjeshtë rrëfimi, si dhe për ta njoftuar lexuesin e të gjitha kohëve se: *“Gjatë gjithë verës, ditë edhe natë, vazhdoi puna për ngritjen e këmbëve të urës. Pasi u hapën gropat e themeleve, gjersa prekën në shkëmb, filloi vendosja e gurëve të mëdhenj. Ata nxirreshin larg, në një gurore të vjetër dhe, pasi i sillnin me qerre gjer këtu, i lëshonin në gropa me anë të një rrotulle, që ata i thonin “çikrik”. Gjervima e tij nuk pushonte as ditën as natën. Herë lëshonte poshtë gurët, të lidhur me konopë të trashë, herë kovat e mbushura me llaç.”*<sup>126</sup> Që në kohët e hershme legjenda e ndërton ngjarjen e saj dhe vetveten duke u ngritur mbi një pyetje të nevojshme se ç’të bëhej që ndërtimi i kështjellës të qëndronte në këmbë dhe të mos prishej natën për t’u gjetur e rrëzuar gjatë çasteve të secilit mëngjes.

<sup>124</sup> Ismail Kadare, (2004), Ura me tri harqe, Onufri, Tiranë, f. 12.

<sup>125</sup> Po aty, f. 37.

<sup>126</sup> Po aty, f. 45.

Duke e njohur këtë pjesë dhe duke qenë se në ndërtimin e saj duhej të ndërhynte ndonjë forcë e fuqishme apo ndonjë flijim për të cilin nuk ishte dëgjuar më parë, mendësia popullore e paraqet motivin e flijimit njerëzor. Të njëjtin motiv të vjetër letrar, të njëjtën prishje dhe rrëzim të ndërtimit që bëhej me ditë e net të caktuara mbi një hapësirë që, për dallim nga legjenda identifikohet me emër dhe mbiemër e paraqet në vetvete edhe romani për të cilin flitet në këtë punim, prandaj lexuesve për harkun e pambaruar të urës u jepen përshkrime për çarje të ndryshme, apo edhe gërvishtje kthettrash, të cilat për njerëzit përreth ishin të pashpjegueshme.

Kjo gjë, duke u mbështetur në bartjen e motivit të flijimit në roman del me fjalët e mëposhtme: *“Nuk kaluan as disa orë për t’u marrë vesh e vërteta: gjatë natës ura ishte dëmtuar në disa vende. Te këmbët e mesit, në kamaret anësore, e sidomos te harku i porsambaruar, ishin bërë disa të çara, ca si gërvishtje kthettrash, gati të pashpjegueshme. Të zverdhur dyllë, ndihmësit e kryemjeshtrit përpiqeshin të gjenin me mend mjetet me të cilat qenë bërë dëmtimet.”*<sup>127</sup>

Gjetje tjetër interesante që përfshihet te të dy tekstet e përzgjedhura është ajo e trupit të murosur, një element po aq sa i bukur, aq edhe i papritur për qenien dhe shoqërinë njerëzore. Përderisa te legjenda popullore personazhi që murosset lexuesve u bëhet i njohur nëpërmjet kapërcimit të njëpasnjëshëm të hapave të rrëfimit (si: biseda me plakun e mençur, shkelja e fjalës së vëllezërve të mëdhenj, arsyet e dy nuseve të mëdha, apo flijimi i nuses së vogël), gjë që ata i çon ta dinë se mbi nusen e tretë, nënën e një fëmije që qante tashmë kishte rënë pesha e flijimit, në romanin e Kadaresë personazhi që murosset paraqitet për një moment të vetëm dhe pa shenja të paralajmëruara.

Shfaqja e tij tashmë në brendi të urës dhe të gjitha veprimet e familjarëve, sidomos të nënës së tij janë përshkrimet më të thella në roman. Për dallim nga personazhi i legjendës që pranon të murosset në kështjellë me vetëdije të plotë për ta çuar në vend besën të cilën e kishte dhënë burri i saj, në roman personazhi që murosset del i identifikuar me emër dhe mbiemër të plotë, i njohur si i rëndomtë jo vetëm për familjen, por edhe për gjithë të tjerët. Andaj, duke u mbështetur në këtë bartje letrare, në dukurinë e intertekstualitetit dhe në këto karakteristika që duken mbi të, rrëfyesi i ngjarjeve të romanit, murgu Gjon, pas ndodhisë së (para)caktuar del me fjalët e mëposhtme:

*“-Ç’është? – thashë, - Ç’keni kështu?*

*Ata ngritën duart, i afruan te gryka, sikur të shkullnin andej fjalët.*

*-Te ura, Gjon... nën harkun e parë... kanë muruar Murrash Zenebishën.*

*-Mos.*

*Nuk isha në gjendje të thosha asgjë tjetër, madje as të mendoja. Kurse ata, që kishin pushuar, siç duket, së menduari përpara meje, prisnin diçka nga unë. Pas pak e gjeta veten duke ecur drejt urës. Më tepër se ecje, kjo ishte një si valëvitje e tri rreckave, unë në mes dhe ata të dy anash, që era po i çonte në drejtimin që donte ajo.*

*E njihja Murrash Zenebishën. Vështirë që midis të rëndomtëve të gjeje njeri më të rëndomtë se ai. Pamja, shtati mesatar, gjithë jeta e tij ishin të zakonshme gjer në lodhje. Nuk mësohesha dot me mendimin se pikërisht atij i kishte rënë në pjesë kjo gjë e pazakonshme: murimi. Sa më shumë që e mendoja, aq më fortë më dukej një lajthim. Ishte më tepër se të bëheshe prijës, shtatore... Gjithçka kishte shkuar tepër larg... Midis nesh dhe atij kishte hyrë llaçi i gojdhënës.”*<sup>128</sup>

Murosja e Murrash Zenebishës që njëri ndër lajmet më të përfolur dhe ndër veprimet më të papritur e të pazakontë për shoqërinë e kohës, te e cila, si në roman, si në rrjedhën e përditshmërisë arrinin të binin dhe të dukeshin ngjarjet më të çuditshme. Prandaj edhe në roman duke u mbështetur në atë që ka thënë autori, shihet se për njerëzit e kohës murosja e tij bëhej më e pazakontë dhe më e përfolur duke u paraqitur nevoja që për ta parë foshnjën e tij, t’ia linin

<sup>127</sup> Ismail Kadare, (2004), *Ura me tri harqe*, Onufri, Tiranë, f. 55.

<sup>128</sup> Po aty, f. 91.

syryn jashtë. Ja se si e jep këtë autori me fjalët e romanit: *“Gjithë ato ditë nuk flitej veçse për murimin e Murrash Zenebishës. Tregoheshin gjërat më të besueshme, fjalët që ai gjoja paskësh thënë në çastin kur po e murosnin, si edhe lutjen e tij të fundit për t’i lënë sytë jashtë, që të mund të shihte foshnjën motake. Disa e zëvendësonin foshnjën me vetë urën, e të tjerë e lidhnin porosinë e tij të fundit jo vetëm me familjen, por me detyrën, hyjnitë, madje dhe me krejt principatën.”*<sup>129</sup>

Kërkesa e tij që njëri sy t’i mbetet jashtë, që përveç foshnjës që duhej ta shihte, të bëhej edhe dëshmitar i të gjitha ecjeve dhe ndodhive të cilat do të bëheshin pjesë e urës, çon menjëherë te kërkesa njerëzore e vetë nuses së vogël përballë kështjellës së Rozafës, e cila kur mësoi nga kunati i saj i madh që jeta e saj i ishte lidhur me një ditë të zezë dhe se për një mbajtje të besës së dhënë duhej t’i sosej jeta në murin e kështjellës, i la fjalët e porosisë së mëposhtme: *“Po unë do t’ju lë një porosi: kur të më mureni në mur, synë e djathtë të ma lini jashtë, dorën e djathtë të ma lini jashtë, këmbën e djathtë të ma lini jashtë, gjirin e djathtë të ma lini jashtë. Se djalin e kam të vogël. Kur të nis të qajë - me njërin sy do ta shikoj, me njërin dorë do ta ledhatoj, me njërin këmbë do t’i tund djepin e njërin gjë do t’ia jap ta pijë. Gjiri im u nguroftë, kështjella qëndroftë, djali im trimëroftë, u bëftë mbret e mbretëroftë”*.<sup>130</sup>

Porosia e këtillë nuk e tregon vetëm guximin e një nëne të re për ta sosur jetën dhe për ta lënë vetëm fëmijën e saj, ngase në anën e kundërt e tregon edhe guximin e saj për ta mbrojtur fjalën e bashkëshortit dhe për të mos e thyer atë për të cilën ai ishte zotuar me veten përpara plakut të mençur dhe dy vëllezërve të tij, shkelës të besës. Këtë porosi të nuses së vogël, përpos variantit të lartshënuar në rreshta, studiuesit dhe lexuesit e ndryshëm e gjejnë edhe në variantin me vargje, në të cilin gjithashtu shihet se kjo grua e fortë e kohës, pavarësisht gjërave të cilat do t’i linte në tokë pas murosjes së saj, në vetvete e mban urimin e saj që djali i saj përballë qëndrimit të një ure, t’i rritej mbarë nga përkundjet e djepit, t’i trimërohej çdo ditë e më shumë, si dhe me fuqinë të cilën do ta arrinte, të luftonte përballë të keqes, të bëhej mbret dhe të mbretëronte në të gjitha hapësirat e tokës së tyre (dhe jo vetëm):

*“Shndosh ju, o kuneti;  
Nji amanetr-o po ju la,  
Kur në mur-o t’më mureni,  
Syn e djathtë t’m’a leni jashtë,  
Dor’n e djathtë t’m’a leni jashtë,  
Kamb’n e djathtë t’m’a leni jashtë  
Gjin e djathtë t’m’a leni jashtë  
Se e kam lanë djalin të vogël  
E kur t’nisën djali gjamën,  
Me nja’n sy t’a shikoj,  
Me nja’n dorë t’a lëmoj,  
Me nja’n kambë t’a lurtoj,  
Me nja’n gjë t’a nërgoj.  
Gjuni i em u nguroftë  
E kalaja u forcoftë,  
Djali i em e gëzoftë,  
U baftë krajl e luftoftë!”*<sup>131</sup>

Duke u mbështetur në këtë bartje të moçme letrare shihet se mënyra se si në legjendë dhe në roman paraqiten dy personazhet, jeta e të cilëve bëhet e gurtë për një arsye të vetme: qëndrimin në këmbë të një ndërtimi të kohës, është njëra ndër mënyrat e bukura mbi të cilat

<sup>129</sup> Ismail Kadare, (2004), Ura me tri harqe, Onufri, Tiranë, f. 101.

<sup>130</sup> Mitrush Kuteli, (2003), Tregim të moçme shqiptare, ÇABEJ&FENIKS, Tetovë, f. 14.

<sup>131</sup> At Bernadin Palaj & At Donat Kurti, (2005), Eposi i Kreshnikëve dhe Legjenda, Plejad, Tiranë, f. 298.

letërsia shqipe e ka paraqitur të plotën e vetvetes, apo edhe është bërë zë i vazhdueshëm i gjërave të cilat nuk duhej të mbuloheshin nga harresa popullore.

Prandaj, bartja e këtillë lexuesin e sotëm, nuk e njeh vetëm me një ngjarje që e ka përshkruar popullin shqiptar, por edhe me një nevojë të vazhdueshme që rrëfyesit e caktuar të bëheshin dëshmitarë të gjërave të ndryshme që binin mbi shoqërinë njerëzore. Në këtë mënyrë, shumë lehtë kuptohet se përse murgu Gjon në fund të romanit i thotë fjalët e mëposhtme: *“Unë murgu Gjon, i biri i Gjorg Ukcames, që e kreu ate tue kujtuom se ndë gluhën tonë ende s’ka gja të shkruom për Urën e Ujanës së Keqe dhe për gjamën që po vjen, dhe en së dashunës botës sanë.”*<sup>132</sup>

## Përfundimi

Duke e njohur krijimtarinë e Ismail Kadaresë dhe duke u ndalë te personazhi i tij i veçantë shihet se mënyra e karakterizimit dhe tipizimit të personazheve të tij nuk vjen vetëm si nevojë e shprehjes dhe përshkrimit artistik në periudhën në të cilën ai i “lindi” krijimet e veta, por edhe si ndikim i rrethanave hapësinore dhe kohore në të cilat personazhet e tij u vendosën për veprim. Në këtë mënyrë duke e njohur larminë e tyre dhe duke e ditur shpërthimin dhe përshkrimin e tyre në situata historike, mitike apo moderne, shihet se në të gjitha kohët, në të gjitha periudhat personazhet e tij nuk janë vetëm me zërin e kohës së re, por edhe të një kohe paraprake, kohë kjo në të cilën ata as nuk kanë jetuar. Duke dalë në pah koha e fundit dhe duke u ringjallur një histori e kaluar, qoftë edhe ajo më e vjetra, në letërsinë e kohës së sotme vihet në pah dukuria e ashtuquajtur intertekstualitet. Për këtë të fundit në brendi të këtij punimi u paraqit personazhi që murosset në urë dhe motivi bartës i flijimit të moçëm njerëzor.

Lexuesit e Kadaresë në tërësinë e faqeve të veprave të tij, të cilat nisen nga fati i një Shqipërie të nevojshme për t’u dukur e bardhë e për të qenë e lirë për ta nisur jetën, do ta gjejnë përherë vetveten, një të dytë, apo edhe një të tretë që ka lidhje me to, gjithnjë të fshehur prapa një personazhi që harron të dalë nga zinxhiri i trashëguar ndër kohë, që harron ta kërposë dhimbjen dhe të mos e gjejë vetveten në norma të ftohta, që harron të bëhet pjesë e një emocioni të vërtetë e të vjetër njerëzor, që harron të dalë nga kornizat e një shoqërie (për)dhunuese, që harron të rrijë në botën e largët sa herë që në atdhe e gjen të vjetrën dhe pjesën që dhemb, apo edhe sa herë që harron ta rrisë vetveten për të mos u bërë hallkë e një zinxhiri që ende pa u plotësuar ia soste jetën. Të gjitha këto motive të reja letrare dhe elemente të bartura nga periudha në periudhë, të cilat dalin në faqet e krijimeve të Kadaresë, në të cilat nuk mbetet anash as edhe e errëta, e zymta dhe e ftohta e kohës në fjalë janë gjërat mbi të cilat u ndërtua letërsia e tij, u njoh nga të tjerët dhe u bë pjesë e intertekstualitetit si dukuri e veçantë në studimet letrare.

## Referencat

- [1]. Çabej, E., (2013), Meshari i Gjon Buzukut 1555, Çabej, Tiranë;
- [2]. Kadare, I., (2004), Ura me tri harqe, Onufri, Tiranë;
- [3]. Kuteli, M., (2003), Tregime të moçme shqiptare, ÇABEJ&FENIKS, Tetovë;
- [4]. Palaj, At B.,&Kurti, At D., (2005), Eposi i Kreshnikëve dhe Legjenda, Tiranë;
- [5]. Sinani, Sh., (2009), Për prozën e Kadaresë, Naimi, Tiranë.

---

<sup>132</sup> Ismail Kadare, (2004), Ura me tri harqe, Onufri, Tiranë, f. 140.